



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

E.nr.1166/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit : M.Xh. nga Ferizaj të cilën e përfaqëson av Arben Isufi nga Ferizaj , kundër debitorit Komuna Ferizaj - DKA Ferizaj , për pagesën e pagave të papaguara si dhe shpenzime të procedurës , më datë 11.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.1166/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1166/23, të datës 04.08.2023, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit DKA Ferizaj, për pagesën e shpërblimit të papaguara pagave dhe shpenzime të procedurës , në bazë të pajtimit 2022:266971 të datës 23.06.2023.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 18.10.2023,e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 579.50 euro , në llogarinë e të autorizuarit të kreditorës .

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.1166/23 më datë 11.06.2024.

GJYQTARI
Faton Ajvazi